



Termet e Referencës

Institucioni:	Fondacioni "Fryma e Dashurisë" Diakonia Agapes
Programi që po e kërkon	Fuqizimi socio-ekonomik i grave në zonat rurale në Shqipërinë e Mesme
Shërbimi i kërkuar	Ngritje kapacitetesh për anëtarët e shoqatave: - "Gratë për ferma të qëndrueshme" në Njësinë Administrative Shushicë; - "Gratë bletërritëse të Shpatit" në Njësinë Administrative Gjinar; si dhe - "Gratë fermere të Treganit" në Njësinë Administrative Tregan
Vendi ku kërkohet shërbimi	Bashkia Elbasan Njësitë Administrative Tregan, Gjinar dhe Shushicë.
Periodha që kërkohet shërbimi	Maj – Shtator 2022
Afati përfundimtar i pranimit të aplikimit	10 Maj, 2022

1. Prezantim i përgjithshëm

Diakonia Agapes është zyra sociale, zhvilluese dhe e emergjencës e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, e themeluar në vitin 1992 me iniciativën dhe bekimin e Kryepiskopit Anastas. Që prej vitit 2000 zyra operon brenda Fondacionit "Fryma e Dashurisë".

Misioni: Diakonia Agapes për të shprehur dashurinë sakrifikuese të Perëndisë për njerëzimin punon me të gjithë, veçanërisht me grupet në nevojë në Shqipëri dhe Rajon, për më shumë shpresë, besim, përgjegjshmëri dhe vetiniciativë përmes asistencës teknike, ndërgjegjësimi dhe lehtësimi të situatave emergjente.

Vizioni: Dashuri që bën ndryshime.

2. Informacion rreth projektit

Projekti "Fuqizimi socio-ekonomik i grave në zonat rurale në Shqipërinë e Mesme", financohet nga Bread for the World, Gjermani dhe zbatohet nga Fondacioni "Fryma e Dashurisë" / Diakonia Agapes. Projekti ka filluar më 1 Prill 2021 dhe përfundon në 31 Mars 2024. Projekti zbatohet në Bashkinë Elbasan në Njësinë Administrative Shëngjin (fshatrat Shëngjin, Jagodinë, Bujqës) si dhe në Njësitë Administrative Tregan, Gjinar dhe Shushicë.

Qëllimi i projektit është të përmirësojë situatën socio-ekonomike të grave në zonat rurale në Shqipërinë e Mesme. Projekti synon të zhvillojë me anë të aktiviteteve të tij ndërthurjen e mbështetjes ekonomike me fuqizimin gjinor. Gratë janë kontribuese të vlefshme dhe kanë aftësi për të rritur standardet e tyre të jetesës në familje por edhe në komunitet. Diakonia Agapes synon rritjen e statusit të tyre shoqëror nëpërmjet mbështetjes ekonomike dhe fuqizimit gjinor në këtë projekt.

Trajnimet teknike të shoqëruara me demonstrime praktike nga specialistë të DA-së do të rrisin kapacitetet dhe aftësitë e grave në fermat e tyre bujqësore. Diakonia Agapes do ti kushtojë

vëmendje forcimit të shoqatave të grave fermerë të krijuara në zonën e synuar të projektit. Shoqata është një faktor kryesor në koordinimin e shitjeve, transportin si dhe përqasjen që duhet të ketë në treg me produktet lokale.

3. Qëllimi i Shërbimit:

Në kuadër të aktiviteteve të projektit: “Fuqizimi socio-ekonomik i grave në zonat rurale në Shqipërinë e Mesme”, kërkohen Ekspert ose Grup Ekspertësh të cilët gjatë periudhës Prill – Shtator 2022, do të ofrojnë workshope të cilat synojnë ngritjen e kapaciteteve për anëtarët e shoqatave fermere të përfshira në projekt:

- Shoqata: “Gratë për ferma të qëndrueshme” në Njësinë Administrative Shushicë;
- Shoqata: “Gratë bletërritëse të Shpatit” në Njësinë Administrative Gjinar; si dhe
- Shoqata “Gratë fermere të Treganit” në Njësinë Administrative Tregan.

Ngritja e kapaciteteve do të bazohet në Strategjinë e Punësimit dhe Aftësive 2014-2020 dhe Strategjinë e Barazisë Gjinore 2014 - 2020. Temat trajnimit do të përfshijnë çështje në lidhje me:

- Menaxhimi i financiar i shoqatave;
- Branding i produkteve: Mbështetja e nevojshme për të krijuar një markë të fortë të produkteve për të konkurruar në tregje të ndryshme;
- Strategjitë e negocimit për të pasur shoqata efektive fermerësh.

4. Rolet dhe përgjegjësitë e Ofruesit të Shërbimit:

- Përgatitja e modulit për workshopet (të përfshihen të tre temat) dhe përgatitja e një raporti përfundimtar;
- Ofrimi i workshopeve për gratë 3 workshope për 3 grupe/ 15 pjesëmarrës secili grup);
- Të punojë ngushtë me stafin e projektit të DA-së.
- Përdorimi i mjeteve të duhura për vizibilitetin gjatë realizimit të workshopeve.

5. Përvoja e kërkuar dhe aftësitë e Ofruesit të Shërbimit:

- Diplomë universitare në Bujqësi / Agro-biznes / Ekonomi e ndërthurur me trajnime në fushën për të cilën kërkohet shërbimi
- Njohuri të mira në fushën e operimit të shoqatave kryesisht në fushën e bujqësisë dhe agro-përpunimit;
- Të ketë eksperiencë në fushën e këshillimit mbi Brandimin e produkteve bujqësorë dhe strategjive të negocimit të produkteve
- Të paktën 5 vite eksperiencë në fushën e ofrimit të trajnimeve në çështjet për të cilat kërkohet shërbimi
- Të ketë eksperiencë në fushën e këshillimit mbi Brandimin e produkteve bujqësorë dhe strategjive të negocimit të produkteve;
- Kapacitete për të zhvilluar ëorkshope me qasje praktike
- Aftësi të mira interpersonale dhe i/e aftë të punojë me grupe të ndryshme njerëzish;
- Aftësi të mira planifikuese dhe organizative;
- Komunikim profesional dhe etik.

6. Propozimi/Dokumente të kërkuara për dorëzim:

- Letër interesi për shërbimin (jo më shumë se një faqe A4);
- Curriculum Vitae (duke evidentuar ekspertizën dhe shërbime të ofruara);
- Fotokopje të diplomës dhe Çertifikatave;
- Fotokopja e Kartës së Identitetit/Pasaportës.
- Draft të metodologjisë së propozuar së bashku me planin e punës;
- Ofertën financiare

7. Procedura e aplikimit:

Subjektet apo individët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentacionin e kërkuar në:

Email: daoffice@diakoniagapes.org

ose në zarf të mbyllur në adresën:

Diakonia Agapes

Rruga "Ibrahim Rugova"

Katedralja Orthodhokse

Tiranë - Shqipëri

Afati përfundimtar për pranimin e aplikimit është 10 Maj, 2022, ora: 16:00.

Aneks / Annex 1

DIAGONIA AGAPES					
REQUEST FOR PRICE / KËRKESË PËR OFERTË: Ngritje kapacitetesh për anëtarët e shoqatave / Capacity Building for the members of the Associations					
			Date / Data	Name / Emri	
No. Nr.	Service Description Përshkrimi i shërbimit	Unit / Njësia	Quantity / Sasia	Price with VAT Çmimi me TVSH (ALL)	Value in VAT/ Vlera me TVSH (ALL)
1	Përgatitje moduli dhe raporti (3 tema) and raport preparation (3 topics)	Module	Njësi / Unit	1	
2	Tarifë eksperti / Expert fee		Ditë/ Days	9	
		Total			
Kushtet e pagesës Payment Terms		Payment to be made after receiving the invoice / Pagesa të kryhet pasi të jetë marrë fatura			
Koha e marrjes së porosisë Lead Time		DA will notify the service provider at least 2 (two) days before the activity DA do të njoftojë ofruesin e shërbimit të paktën dy ditë para aktivitetit			
Shënim i rëndësishëm/Important NOTE: Diagonia Agapes parashikon ofrimin e shërbimit për 3 grupe me nga 15 persona secili. Çdo grup do të ndjekë tre workshope (3 takime një ditore për çdo shoqatë) . Takimet janë parashikuar të ofrohen gjatë periudhës Maj - Shtator, 2022. Diagonia Agapes foresees to offer the service for 3 groups of 15 people each. Each group will attend three workshops (3 one day meeting for each association). The meeting will be offered during May - September, 2022. Please keep in mind the EU requirements / Ju lutem mbani parasysh kërkesat e BE.					
			Ofruesi i Shërbimit / Service provider		